

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6901
E hënë, 22 maj 2023
Çmimi 0.40

Haziri, akuza ndaj Kurtit
Qeveria në qiell e populli
në buqillë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA, NIKOQIRE E "DEFENDER EUROPE 2023" | FAQE 4-5

USHTARAKËT E FSK-së PËRKRAH MIJËRA USHTARAKËVE TË 25 VENDEVE TË NATO-s



Nga 21 maji deri më 2 qershor
Kosova do të jetë nikoqire e
stërvitjes më të madhe
ndërkombëtare në rajonin e
Ballkanit "Defender Europe 2023"
[Mbrotësi i Evropës 2023] që do të

mbahet në Babaj të Bokës të
Gjakovës. Ceremonia e hapjes u
mbajt të dielën në sheshin
"Skënderbeu" në Prishtinë. Mbi 1
300 ushtarakë të Forcës së Sigurisë
së Kosovës do të ekzekutojnë

detyra stërvitore ushtarake
përkrah 24 mijë ushtarakëve të
forcave të armatosura të 25
vendeve të NATO-s dhe vendeve
partnere të Shteteve të Bashkuara
të Amerikës

AKTUALE



SEZONI TURISTIK NË SHQIPËRI,
MES SFIDAVE PËR CILËSINË E
SHËRMBIMEVE | F. 2

QUINTI: MOSZBATIMI I VENDIMIT
PËR MANASTIRIN E DEÇANIT
PENGON ANËTARËSIMIN E
KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS

F. 3

PDK-ja, THIRRJE QEVERISË TË KRI-
JOJË KUSHTE PËR MBAJTJEN E
SEANCAVE SOLEMNE TË
KRYETARËVE NË VERI | F. 6

EKONOMI



E VËRTETA E RITJES EKONOMIKE

F. 8

SPORT



RAMA DHE KRASNIQI PARALAJMËROJË
SPEKTAKËL MË 5 GUSHT | F. 10

ESCOBARI:
KOSOVA DHE
SERBIA TA
ZBATOJNË
MARRËVESHJEN
DERI NË FUND
TË VERËS | FAQE 3



NAGIP
KRASNIQIT I
VAZHDOHET
PARABURGIMI
EDHE PËR
DY MUAJ | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289
E-mail: renovamt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Sezoni turistik në Shqipëri, mes sfidave për cilësinë e shërbimeve

TIRANË, 21 MAJ - Sezoni turistik në Shqipëri ka nisur me grupet e vizitorëve në trashëgiminë kulturore dhe në pasuritë natyrore. Organizata Botërore e Turizmit e renditi pak ditë më parë Shqipërinë në vendin e tretë në botë për nga prurjet turistike në tre muajt e parë të këtij viti me një rritje 54 % të numrit të turistëve krahasuar me vitin 2019.

Shqipëria ndjek trendin global ku në tre muajt e parë të këtij viti u shënuan rreth 235 milionë turistë, dyfishi krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Vasil Garo, një operator turistik në Gjirokastër, thotë se interesimi i lartë duket këtë vit me prurjet dhe rezervimet. "Pas pandemisë gjithçka është riorganizuar dhe mundësitë më të mëdha janë drejtuar drejt natyrës. Sot që flasim natyra është në ditë e saj më të mira. Shqipëria vazhdon të jetë një vend që nuk e ka humbur virgjërinë e natyrës, autenticitetin e saj. Me krijimin e Lumit Vjosës Park Kombëtar u shtuan dhe më shumë mundësitë dhe u bë një jehonë më e madhe dhe aty është vërtet zona ku ne duhet të fokusohemi dhe të ngremë shërbimet".

Sfida kryesore e sektorit për

këtë vit pritet të jenë stafet e qëndrueshme dhe të kualifikuara, thotë më tej Garo. "Ne kemi hasur mungesën e punëtorëve dhe stafëve afatgjatë, pavarësisht pagesave dhe kushteve të punës. Lëvizja tani dhe emigrimi nuk është më nevojë, por është kthyer në një trend sepse të gjithë po ndjekin njëri-tjetrin dhe kjo është më shqetësuese. Normalisht ka pjesë për të përmirësuar. Ne duhet të rrisim cilësinë e shërbimit dhe këtu duhet të punojmë shumë. Por edhe tek pjesa ku kemi punuar gjatë këtyre viteve për të rritur cilësinë e shërbimit, ku kemi bërë trajnime, janë kontraktuar kompani nga më seriozet në Shqipëri për të trajnuar këto stafe, prapë kemi vërejtur që punëtorët dhe stafet nuk kanë qenë të qëndrueshme".

Digjitalizimi është një formë e re e rezervimeve dhe agjencitë turistike po e automatizojnë aktivitetin, por edhe ky sistem ka nevojë të përmirësohet, thotë Garo. "Sidomos për bizneset e reja dhe në zonat që janë pak të zhvilluara siç është rajoni jonë, shembull bujtinat në fshat etj., nuk kanë akoma informacionin e nevojshëm apo qasjen e duhur dhe të saktë drejt këtyre rezervimeve pasi këto në shumicën e tyre që ti



kesh 100 % të sigurta duhet të bashkëpunosh me bankat, duhet të ndjekësh pagesat. Shumica janë të paregjistruar, disa refuzojnë të paguajnë komisionet e bankave, janë disa problematika të tilla që unë i quaj bazike dhe që duhet të gjejnë zgjidhje. Gjithsesi, automatizimi i shërbimit të rezervimeve dhe klientëve është gjë shumë e mirë dhe gjithçka po lëviz drejt këtij procesi". Turizmi natyror po tërheq gjithnjë e më shumë interes dhe po rrit kërkesën për shërbime, thotë Ilir Hitaj që punon për një

kompani që organizon udhëtime me kuaj në disa zona në Jug të Shqipërisë.

Humbja e jetës së tre turistëve në Shqipëri në aksidente të veçuara në parqe natyrore të cilët nuk kanë qenë nën udhëheqjen e guidave ka sjell këtë vit një vëmendje më të madhe për masat për mbarëvajtjen e turizmit të tërësor.

Olsi Lafe një ekspert turizmi dhe një udhërrëfyes kombëtar thotë se qeveria qendrore dhe qeveritë komunale së bashku me sipërmarrjet kanë një rol të

rëndësishëm në politikën informuese dhe orientuese për turistët.

Lafe vlerëson se mbështetja e udhërrëfyesve është mjaft e rëndësishme për turizmin shqiptar.

Sipas të dhënave zyrtare, vitin e shkuar Shqipëria njohu një prurje turistike prej rreth 7.5 milionë vizitorësh me një rritje mbi 32 % në krahasim me vitin 2021. Por rritja e prurjeve sipas analistëve po e vë sektorin në përgjegjësi të mëdha për të përballuar këtë interesim me shërbime cilësore.

Bideni paraqiti një pako të re ndihme amerikane për Ukrainën

TOKIO, 21 MAJ - Presidenti Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, njoftoi të dielën, më 21 maj, për një pako të re ndihme ushtarake për Ukrainën në luftën kundër pushtimit rus, e cila përfshin municion, artileri dhe automjete të blinduara.

Gjatë një takimi me presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskyi, i cili u mbajt në Japoni, Biden tha se ShBA-ja po bën gjithçka që mundet për ta forcuar mbrojtjen e Ukrainës në luftën e nisur nga Rusia më 24 shkurt të vitit të kaluar.

Biden u takua me presidentin ukrainas në margjinat e samitit të Grupit Shtatë (G7) në Hiroshimë, i cili mbledhi së bashku liderët e ekonomive kryesore të botës – SHBA-së, Japonisë, Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Francës, Italisë dhe Kanadasë.

Udhëheqësit e G7-s ia sinjalizuan Rusisë gatishmërinë për të qëndruar pranë Ukrainës në terma afatgjatë, raporton "Reuters".

Zelensky tha të dielën se ai "ia prezantoi botës formulën



ukrainase të paqes me dhjetë pika", gjatë një takimi me liderët botërorë në samitin në Japoni. "Për sa kohë që pushtuesit janë në vendin tonë, askush nuk do të ulet në tryezën e bisedimeve me Rusinë", shkroi Zelensky në Twitter, duke theksuar se "bota

ka fuqi të mjaftueshme për të detyruar Rusinë të bëjë paqe". "Bota jonë është e madhe, por ne jemi të gjithë së bashku në të. Që nga Japonia e deri te vendet arabe, nga Evropa në Amerikën Latine, ne gjejmë mbështetje për formulën tonë", tha ai.

Mbështetja e G7-s për Ukrainën

Samiti i Hiroshimës u fokusua në luftën e Rusisë në Ukrainë, sigurinë ekonomike, investimet e gjelbra dhe situatën në

rajonin Indo-Paqësor.

Kryeministri japonez Fumio Kishida vlerësoi të dielën se ishte "e rëndësishme" që liderët e G7-s treguan solidaritet për të mbështetur ligjin dhe rendin ndërkombëtar, gjatë samitit ku presidenti ukrainas ishte i ftuar.

Këtë deklaratë Kishida e bëri në një konferencë për shtyp, me të cilën e mbylli samitin tre-ditor në Hiroshimë.

Presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky, në ditën e fundit të samitit iu dha mundësia për të fituar vëmendjen e vendeve si Brazili dhe India, shkruan "Reuters".

Kancelari gjerman Olaf Scholz tha se programet e mundshme të aleatëve për trajnimin e pilotëve ukrainas për avionët luftarakë F-16 ishin një mesazh për Rusinë se nuk pritet sukses në pushtimin e Ukrainës, madje edhe nëse konflikti është afatgjatë.

Shtetet e Bashkuara kanë njoftuar sanksione kundër më shumë se 300 objektivave, që synojnë të ndëshkojnë Rusinë për pushtimin e saj në Ukrainë.

Escobari: Kosova dhe Serbia ta zbatojnë marrëveshjen deri në fund të verës

PRISHTINË, 21 MAJ - I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, vlerësoi se marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës është një "arritje e madhe" dhe se ajo paraqet një "hap historik përpara" në zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Në një intervistë për agjencinë Mina, Escobar tha se "nuk shihet arsye" pse marrëveshja për çështjet e mbetura të mos mund të arrihet deri në fund të verës, transmeton Beta. Siç tha ai, në Serbi ka disa elementë që duhet të plotësohen sa i përket njohjes së targave të veturave, letërnjoftimeve dhe disa gjërave të tjera. "Edhe Kosova pritet ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Më falni, kjo nuk është pritje. Është

obligim", tha Escobar.

Ai tha se Shtetet e Bashkuara duan që këto procese të zhvillohen sa më shpejt që të jetë e mundur. "Nuk shoh asnjë arsye pse të mos mund të përfundojë deri në fund të verës", tha Escobar.

Ai përkujtoi se marrëveshja mes dy palëve është ligjrisht e detyrueshme dhe se tani shtrihet pyetja se si të zbatohet plotësisht. Escobar tha se është optimist se qëllimi do të arrihet dhe beson se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq "mund ta tregojnë guximin e nevojshëm politik për të ndërmarrë hapat e duhur".

Më 27 shkurt Kosova dhe Serbia arritën Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve në Bruksel, ndërsa më 18 mars, në Ohër, u pajtuan për aneksin për zbatimin e saj.



Quinti: Moszbatimi i vendimit për Manastirin e Deçanit pengon anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës

PRISHTINË, 21 MAJ - Shefat e misionëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian, kanë përsëritur thirrjen ndaj Qeverisë së Kosovës që të zbatojë plotësisht dhe me urgjencë regjistrimin e tokës së Manastirit të Deçanit.

Në një deklaratë të Quintit thuhet se pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016, ai vendim për tokën nuk po zbatohet. "Ne jemi të bashkuar në mbështetje të së ardhmes demokratike dhe evropiane të Kosovës. Zbatimi i



sundimit të ligjit dhe respektimi i pavarësisë së gjyqësorit janë obligime për të gjitha qeveritë e

zgjedhura në mënyrë demokratike dhe parakushte të nevojshme për integrimin e

Kosovës në institucionet evropiane dhe euroatlantike, duke përfshirë përparimin e mëtejshëm në aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Vonesa e mëtejshme është vetëm një pengesë për këtë përparim", thuhet në deklaratën e tyre të përbashkët.

Kontesti gjyqësor rreth çështjes se kujt i takojnë 24 hektarë tokë dhe pyll - ndërmarrjeve shoqërore "Apiko" dhe "Iliria" apo Manastirit mesjetar të Deçanit - ka zgjatur 16 vjet. Më 20 maj 2016 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka marrë vendim në favor të Manastirit të

Deçanit, por ai nuk është zbatuar, ndonëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe detyruese për të gjitha palët. Por, këtë vendim, autoritetet lokale të Deçanit nuk e zbatojnë as sot e kësaj dite, duke vlerësuar se kjo sipërfaqe u mor me dhunë në vitet '90 nga regjimi i udhëheqës të atëhershëm serb, Slobodan Millosheviq. Tash e disa vjet bashkësia ndërkombëtare u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës që ta zbatojnë këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe ta lejojnë Manastirin që ta regjistrojë tokën në kadastër.

Patriot Krasniqi zgjedhet kryetar i Degës së PDK-së në Itali

PRISHTINË, 21 MAJ - Puna disamujore për themelimin e nëndegëve të PDK-së në Itali, të udhëhequr nga Komisioni për Organizimin e Partisë Demokratike në Mërgatë, u finalizua të dielën në Firencë me mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor të Degës së PDK-së në këtë shtet.

Në një proces tejet demokratik, me votat unanime të delegatëve, kryetar u zgjodh Patriot Krasniqi. Patrioti është një afarist i suksesshëm në Firencë, që vjen nga një familje atdhetare nga Prizreni dhe me kontribut të madh për vendin. "Ashtu sikur në Zvicër, Suedi, Kanada dhe shumë shtete të tjera, edhe sot në Itali, bashkë me mërgimtarët tanë të shumtë, rifilluam një rrugëtim të përbashkët politik e kombëtar, që

në themel të tij ka kontributin për Kosovën dhe për qytetarët tanë. Kosova asnjëherë nuk do të mund ta realizojë gjithë potencialin e vet pa pjesëmarrjen direkte të mërgimtarëve tanë në vendimarrje dhe në jetën publike", ka thënë kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi.

Ai ka thënë se një gjë është e sigurt. "Rikthimi i PDK-së në mërgatë nuk është rikthim i përkohshëm e as sezonal. Është rikthim reformues, sepse ne kemi nevojë për njëri-tjetrin. Mesazhi dhe zotimi janë të qarta: vetëm bashkë do ta jetësojmë vizionin tonë për transformimin e nevojshëm dhe të domosdoshëm të Kosovës", është shprehur Krasniqi, i cili ishte i pranishëm në këtë kuvend zgjedhor.





KOSOVA, NIKOQIRE E "DEFENDER EUROPE 2023"

Ushtarakët e FSK-së përkrah mijëra ushtarakëve të 25 vendeve të NATO-s

Nga 21 maji deri më 2 qershor Kosova do të jetë nikoqire e stërvitjes më të madhe ndërkombëtare në rajonin e Ballkanit "Defender Europe 2023" [Mbrotjtësi i Evropës 2023], që do të mbahet në Babaj të Bokës të Gjakovës. Ceremonia e hapjes u mbajt të dielën në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë. Mbi 1 300 ushtarakë të Forcës së Sigurisë së Kosovës do të ekzekutojnë detyra stërvitore ushtarake përkrah 24 mijë ushtarakëve të forcave të armatosura të 25 vendeve të NATO-s dhe vendeve partnere të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 MAJ - Nga 21 maji deri më 2 qershor Kosova do të jetë nikoqire e stërvitjes më të madhe ndërkombëtare në rajonin e Ballkanit "Defender Europe 2023" [Mbrotjtësi i Evropës 2023], që do të mbahet në Babaj të Bokës të Gjakovës. Ceremonia e hapjes u mbajt të dielën në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë.

Kosova do të jetë vendi i katërt me më së shumti ushtarakë që do të marrin pjesë në këtë stërvitje në mesin e 25 vendeve pjesëmarrëse.

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti, ministri i Mbrotjtjes, Armend

Mehaj, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Bashkim Jashari, ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier dhe figura të tjera publike.

Presidentja Osmani tha se kjo stërvitje dëshmon guximin, përkushtimin dhe angazhimin e FSK-së: "Ju jeni mishërim i trimërisë dhe përfaqësimit të idealeve më fisnike të shërbimit, sakrificës dhe solidaritetit. Ju jeni gardianë të paqes dhe sigurisë në një botë gjithnjë e më komplekse dhe në zhvillime gjithnjë e më sfiduese".

Presidentja ka thënë se në këtë stërvitje ndërkombëtare ushtarët e Kosovës janë krahas ushtrive nga kombe të ndryshme dhe shtete të ndryshme. "Ju qëndroni të bashkuar nën një kauzë të

vetme, kauzës së përbashkët për ta forcuar bashkëpunimin, për ta ndërtuar besimin dhe për ta rritur ndërveprimin midis forcave aleate. Ju jeni mishërimi i punës në grup, duke kapërcyer kufijtë dhe duke punuar së bashku drejt një qëllimi të përbashkët - sigurisë dhe mbrotjtjes së vlerave tona", ka theksuar presidentja. Sipas Osmanit, ky ushtrim ndërkombëtar është një simbol i vendosmërisë kolektive për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin në një botë që po sfidohet vazhdimisht. "Forca jonë nuk qëndron vetëm në fuqinë e armëve tona, por në lidhjet që krijojmë, në aleancat që ne

ndërtojmë dhe në vlerat e përbashkëta të cilat çdo ditë po i kultivojmë", ka thënë presidentja Osmani.

Më tej, ajo ka theksuar se objektivi kryesor i "Defender 23" është ta shfaqë aftësinë ushtarake dhe luftarake të ShBA-së dhe forcave aleate kundër agresorëve të mundshëm dhe për t'i siguruar aleatët dhe partnerët evropianë se kontinenti është i sigurt nga sulmet e mundshme.

Ky ushtrim është historik në shumë aspekte, ka thënë presidentja, veçanërisht për ushtrinë më të re në kontinentin evropian, për Forcën tonë të Sigurisë. "Pikërisht para dy vjetëve me sukses shumë të lartë

realizuar së bashku Stërvitjen 'Defender-Europe'21' dhe vazhduam pa u ndalur në përgatitjet për stërvitjen e radhës, e cila po fillon sot me ceremoninë në sheshin Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, një ndër emrat më domethënës në historinë tonë. Skënderbeu është hero jo vetëm për Kosovën, por edhe për Evropën. Njihet si strategu dhe udhëheqësi ushtarak ndër më të mëdhenjtë në historinë e luftërave për mbrotjtjen e atdheut dhe mbrotjtjen e vlerave civilizuese që ndikuan fuqishëm edhe në mbrotjtjen e Evropës - kontinentit tonë në përgjithësi", është shprehur Osmani.

E para e vendit ka theksuar se "Defender 2023" përkon edhe me 24-vjetorin e çlirimit tonë, e cila, sipas presidentes, është ditë po aq e freskët sa kujtesa e ndërhyrjes ushtarake të ShBA-së me forcat e vendeve të tjera aleate të NATO-s kundër gjenocidit të Millosheviqit ndaj popullit të Kosovës. "Ne ishim viktimë, kurse regjimi i Millosheviqit ishte agresori. E lufta jonë ishte luftë për liri! Kjo është e vërteta e vetme të cilën do ta mbrojmë çdoherë e kudo!", ka theksuar presidentja.

Ajo ka shtuar se sot tekta i shohim ushtarët e FSK-së të radhitur në këtë shesh, dëshirojnë të sjellin në vëmendjen e secilit edhe



sakrificën e paraardhësve të tyre, vajzave e djemve të UÇK-së, të cilët e bënë të mundshme lirinë tonë, mbrojtjen dhe rikthyen dinjitetin tonë. “Ata janë mishërimi i vetëmohimit, sakrificës dhe guximit. Të prirë nga komandanti legjendar Adem Jashari, ata dhe mbi 3 mijë dëshmorë të UÇK-së janë personifikim i lirisë dhe i shtetit tonë. Prandaj, falënderim dhe mirënjohje e përgjeshme për vajzat dhe djemtë e UÇK-së! Faleminderit edhe për burrat e gratë e popujve të aleancës së lirisë, aleancës së NATO-s dhe gjithë ushtarëve të ShBA-së për sakrificën në përkrahje të përpjekjeve tona për liri dhe pavarësi!”, ka thënë Osmani.

Sipas presidentes Osmani, krahas stërvitjes “Defender-Europe’23”, kjo shtron edhe nevojën e krijimit të përbashkët të frontit politik, sikurse edhe atij të sigurisë e të mbrojtjes, duke filluar me Kartën e Adriatikut, ShBA-A5, ku është e domosdoshme të ecet përpara me anëtarësimin e Kosovës, pastaj me hyrjen e Republikës sonë në Programin e Partneritetit për Paqe e deri tek anëtarësimi në NATO.

Më tutje, presidentja ka thënë se kjo stërvitje ndërkombëtare është dëshmi e fuqisë së bashkëpunimit dhe tregues i aleancës së fuqishme me ShBA-në.

Kurti: Ushtarakët e FSK-së, në krah të mijëra ushtarakëve të 25 vendeve të NATO-s

Kryeministri Kurti fjalën e tij e nisi duke thënë se “sot këtu, në sheshin që mban emrin e kryeheroit tonë dhe njërit prej strategëve më të njohur ushtarak që ka njohur njerëzimi - Skënderbeut, po shënojmë fillimin e ushtrimit të madh të drejtuar nga aleati ynë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës”. Kurti tha me këtë rast se ushtrimi “Defender Europe 23” është ngjarja më e madhe stërvitore ushtarake që ka ndodhur ndonjëherë në Kosovë. “Republika jonë sot është e nderuar që për herë të dytë është vend nikoqir i ushtrimit që shtrihet prej zonës së Mesdheut e deri në kufijtë lindorë të kontinentit tonë. Mbi 1 300 ushtarakë të forcave tona do të ekzekutojnë detyra stërvitore ushtarake në krahë të 24 mijë ushtarakëve të forcave të armatosura të 25 vendeve të NATO-s dhe vendeve partnere të Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, ka thënë kryeministri Kurti.

Më tej, kryeministri shtoi se Forca e Sigurisë së Kosovës në këtë ushtrim radhitet e katërta në



mesin e 25 ushtrive pjesëmarrëse sa i përket numrit të personelit të angazhuar në këtë ushtrim që, siç tha ai, dëshmon për vullnetin që kemi për ta zhvilluar sistemin tonë të mbrojtjes, por edhe përkushtimin tonë të palëkundur për të qenë pjesë e sistemit të përbashkët të mbrojtjes së vendeve që përqafojnë e përfaqësojnë vlerat demokratike. Duke iu uruar suksese për përbashkjen e objektivave të ushtrimit, kryeministri Kurti tha se FSK-ja do të vazhdojë ta ketë mbështetjen e Qeverisë së Republikës dhe institucioneve të shtetit në ngritje dhe zhvillim profesional. “Demokracia, shoqëria dhe vlerat njerëzore kanë nevojë për ushtrinë më shumë se kurrë, sepse

demokracia është sistemi më i brishtë pikërisht sepse është sistemi më i hapur”, tha kryeministri Kurti në fjalën e tij. Ndërkaq ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, theksoi se përgatitjet për realizimin e suksesshëm të “Defender Europe ‘23” kanë filluar që një vit e gjysmë dhe se trajnimet e vazhdueshme, investimi në blerje të pajisjeve dhe sistemeve të armatimit, shkollimet dhe stërvitjet kanë qenë intensive dhe i kanë paraprirë këtij ushtrimi. “Për ne është shumë e rëndësishme që ngritjen e kapaciteteve tona ta bëjmë gjithmonë sipas standardeve të NATO-s, sepse rrugëtimi ynë është i qartë, destinacioni ynë është një dhe i vetëm, anëtarësimi

në NATO. Prandaj ne do ta përbushim çdo detyrë e obligim që të jemi pjesë e kësaj familje të madhe”, ka thënë Mehaj.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë se derisa agresioni rus i Ukrainës po vazhdon, është veçanërisht e rëndësishme të vihet në pah një ushtrim si “Defender Europe 2023”. “Një ndër qëllimet e kësaj stërvitje është që të tregohet aftësia e forcave ushtarake të ShBA-së për t’i zbatuar shpejt trupat dhe pajisjet e gatshme për luftë, për t’i siguruar aleatët, për t’i parandaluar ata që mund ta kërcënojnë paqen në Evropë dhe për ta mbrojtur këtë kontinent nga agresioni”, ka pohuar ambasadori amerikan. Sipas tij, stërvitjet kanë edhe një qëllim tjetër “që ta shfaqë përkushtimin e aleatëve dhe partnerëve tanë evropianë për ta përmirësuar shkallën, kapacitetet dhe ndërveprueshmërinë e ushtrive të tyre”. Ai tha se 9 000 ushtarakë amerikanë do të marrin pjesë në stërvitjen “Defender Europe 2023”.

Pas fjalëve hyrëse, u bë prezantimi statik i pajisjeve të FSK-së. Qytetarëve të Kosovës të dielën u është bërë e mundshme të shohin nga afër një pjesë të njësive, pajisjeve dhe automjeteve të ushtrisë.



Haziri, akuza ndaj Kurtit: Qeveria në qiell e populli në buqillë!

PRISHTINË, 21 MAJ - Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, ka thënë se ekipi i kryeministrit Albin Kurti është i “paaftë”, ndërsa populli është në vështirësi, pasi shet “mjegull” për ta mbuluar paditurinë. Sipas tij, veç Kurti e di se cili prokuror, gjykatës, polic, mjek, anëtar bordi, kryeshf agjencie e drejtues të tjerë institucionalë i pëlqen atij, kryekuvendarit dhe presidentes.

Haziri e ka akuzuar Kurtin se nuk është duke dhënë përgjigje për një sërë çështjesh siç është draftimi i Asociacionit për



vetëmenaxhimin e Komunave me Shumicë Serbe ose kur do të

zbatohet vendimi për hapjen e urës së Ibërit që, sipas Hazirit,

ky vendim është marrë me urdhër të Kurtit. “Kurti nuk tregon kur betohen kryetarët e rinj të komunave veriore, kur kthehen zyrtarët bojkotues të institucioneve në veri, kur zbaton draftimin e Asociacionit për vetëmenaxhimin e komunave me shumicë serbe e kur zbaton vendimin me kërkesën e tij për hapjen e urës për veriun e Mitrovicës”, ka shkruar Haziri në “Facebook”. Më tej, ai ka thënë se kryeministri nuk ka një datë se kur do të përfundojnë autostradat e nisura për Gjilan, Mitrovicë e Pejë. “Kurti nuk

tregon planin për kthimin e refugjatëve në atdheun e tyre për Mitrovicë dhe komunat në veri, nuk tregon kur ua kthen buxhetin vetjak komunave, nuk tregon kur përfundon autostrada për Gjilan, Mitrovicë e Pejë, si dhe 780 milionë euro të investimeve kapitale kur përfundojnë. Kurti nuk tregon kur ta merr shpresën se i duhet për ta vazhduar shitjen e mjegullës politike për paaftësinë e ekipit dhe bedelëve të tij... Për të tjerët s’ka gjalle. Populli thotë: Qeveria në qiell e populli në buqillë!”, ka përfunduar Haziri.

Nagip Krasniqit i vazhdohet paraburgimi edhe për dy muaj

PRISHTINË, 21 MAJ - Kryeshefit të KEK-ut, Nagip Krasniqit, i është vazhduar paraburgimi edhe për dy muaj, ka njoftuar Gjykata Themelore në Prishtinë.

Gjykata Supreme të mërkurën e kishte refuzuar të pabazë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj të pandehurit N. K., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe

aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Supremja e ka vlerësuar të pabazë kërkesën e mbrojtjes për lirim nga paraburgimi të Krasniqit.

Krasniqi u arrestua më 19 prill nën dyshimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare, ushtrimit të ndikimit dhe konfliktit të interesit. "Gjatë bastisjes janë sekuestruar dokumente të ndryshme që ndërlidhen me

rastin, pajisje elektronike si tre kompjuter, një llap-top, një celular, një USB, në cilësi të provave materiale që do të shërbejnë për procedurën e mëtejme", kishte njoftuar prokuroria.

Disa ditë më vonë Bordi i Drejtorëve të KEK-ut mori vendim për pezullimin e Nagip Krasniqit nga detyra e punës së kryeshefit ekzekutiv, me efekt të menjëhershëm.



Konjufca: Ta bëjmë diasporën komponentë vendimtare të zhvillimit ekonomik

PRISHTINË, 21 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka vlerësuar lart rolin e diasporës në arritjet e popullit shqiptar përgjatë historisë.

Në hapje të Konferencës "Diaspora flet", në sallën plenare të Kuvendit, kryetari Konjufca tha se mërgata mbetet themeli i çdo të arritje të shtetit të Shqipërisë dhe Kosovës, me kontribut konstant nga Rilindja deri të organizimi i luftës sonë të lavdishme çlirimtare në krye me UÇK-në.

Kreu i Kuvendit shtroi nevojën që të dy shtetet, Shqipëria dhe Kosova, të krijojnë mekanizmat e nevojshëm për ruajtjen dhe mbrojtjen e identitetit, kulturës



dhe gjuhës, si dhe për ta bërë diasporën komponentë vendimtare të zhvillimit ekonomik.

Kryetari Konjufca shtoi se nëse

kontributi i diasporës ishte një kapitull, tani ka ardhur koha të hapet kapitulli i dytë. "Dimensioni i parë është krijimi i mekanizmave të fuqishëm për

ruajtjen dhe mbrojtjen e identitetit, kulturës dhe gjuhës së popullit tonë në mërgatë dhe aspekti i dytë është si ta bëjmë mërgatën komponentë vendimtare ekonomike të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Këto dyja janë dy portat kryesore të hapjes së kapitullit të dytë", theksoi Konjufca.

Duke u ndalur te ruajtja dhe afirmimi i identitetit dhe vlerave kombëtare në mërgatë, veçanërisht te gjeneratat e reja, kreu i Kuvendit bëri thirrje për zhvillimin e mekanizmit të mbrojtjes të kulturës dhe gjuhës sonë. "Edukimi dhe arsimiti na e mundësojnë këtë, sepse fëmijët e mërgimtarëve të cilët janë të

lindur dhe po rriten atje, dhe po ashtu janë të integruar shumë mirë në shoqëritë ku jetojnë, kanë mbi të gjithë nevojë për shkollën e cila organizohet drejtpërdrejt prej Republikës së Kosovës dhe e cila, me keqardhje them, dhe pak që besa edhe me faj, nuk ka arritur të organizohet deri tash", deklaroi Konjufca.

Duke u uruar bashkatdhetarëve punime të mbara të kësaj konference, Konjufca shtoi se Kosova dhe Kuvendi janë shtëpia e diasporës.

Konferenca vazhdoi punimet me diskutime të pjesëmarrësve nën udhëheqjen e përfaqësuesit të organizatës GERMIN, Lirim Krasniqi.

PDK-ja, thirrje qeverisë të krijojë kushte për mbajtjen e seancave solemne të kryetarëve në veri



PRISHTINË, 21 MAJ - Sekretari organizativ i Partisë Demokratike të Kosovës, Betim Gjoshi, ka deklaruar se dy kryetarët e komunave nga radhët e PDK-së, në Zveçan dhe në Zubin Potok, po përballen me presion dhe nënçmim nga zyrtarë dhe segmente të qeverisë posaçërisht, sipas tij, nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.

Gjoshi në "Facebook" ka shkruar se të dy komunat kanë thirrur seancat solemne për dhënien e betimit por, sipas tij, ministri i Pushtetit Lokal dhe zyrtarë të kësaj ministrie kanë ushtruar vazhdimisht presion për ndërrimin e datës dhe lokacionit për mbajtjen e seancave. Ai i ka

bërë thirrje qeverisë t'i krijojë kushtet e nevojshme, sa më parë, për mbajtjen e seancave solemne. "Këto veprime të këtyre zyrtarëve nuk janë të bazuara në asnjë arsye legjitime, të cilën ne do ta respektonim pa asnjë problem. Madje, as shkresë zyrtare në lidhje me këto kërkesa nuk kemi pasur. Prandaj, i gjithë ky teatër është një tendencë për t'i nënvlerësuar dhe dekurajuar kryetarët tanë të zgjedhur në këto dy komuna. I bëjmë thirrje qeverisë t'i krijojë kushtet e nevojshme sa më parë për mbajtjen e seancave solemne. Mbi të gjitha, kërkojmë urgjentisht që ky presion, krejt i panevojshëm dhe jashtë çdo

norme etike, të ndalet menjëherë. Dy kryetarët nga radhët e PDK-së, të votuar për t'i udhëhequr komunat e Zveçanit dhe Zubin Potokut, janë të përkushtuar për të punuar në të mirë qytetarëve, pa dallim. Prandaj, për çdo komunikim me ta, i ftojme qeverinë që ta bëjë zyrtarisht dhe bashkëpunimi, sipas ligjit, nuk do të mungojë asnjëherë", ka shkruar Gjoshi. Lëvizja Vetëvendosje ka fituar në Mitrovicë të Veriut dhe në Leposaviq, ndërsa në Zveçan dhe Zubin Potok të parët kanë dalë kandidatët e Partisë Demokratike të Kosovës. Zgjedhjet e jashtëzakonshme në veri të vendit janë mbajtur më 23 prill.

Osmani kujton 24-vjetorin e masakrës së Stagovës

Prishtinë, 21 maj - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka kujtuar masakrën e Stagovës së Kaçanikut, në të cilën qenë vrarë 13 banorë të fshatit. Osmani ka theksuar se qëllimet barbare të regjimit kriminal ishin evidente: shfarosja dhe

spastrimi etnik. "24 vjet më parë forcat paramilitare të regjimit gjenocidal të Serbisë, në fshatin Stagovë të Kaçanikut vranë 13 banorë të fshatit dhe dogjën gjysmën e shtëpive. Qëllimet barbare të regjimit kriminal ishin evidente: shfarosja dhe

spastrimi etnik", ka deklaruar Osmani.

Presidentja ka shtuar: "Kujtimi për martirët e Stagovës është i përhershëm, sikurse edhe përpjekja e vazhdueshme për t'i sjellë autorët e krimeve para drejtësisë".



E vërteta e rritjes ekonomike



PRISHTINË, 21 MAJ - Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës jo rrallëherë lavdërohen për suksesin që ka arritur vendi sa i përket rritjes ekonomike. Gjatë kësaj jave edhe të dhënat e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) treguan se Kosova ka rritjen ekonomike më të lartën në rajon. Sipas këtij institucioni financiar ndërkombëtar, Kosova pritet të ketë rritje ekonomike 3.5 për qind këtë vit dhe deri në 4 për qind vitin e ardhshëm. Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, në një postim në rrjetin social "Facebook", vlerësoi se kjo është meritë e punës së Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Albin Kurti. "Këto rezultate, nuk janë të rastësishme. Trajektorja në të cilën e kemi drejtuar vendin, është ajo e duhura, ku frytet dhe benefitet do t'i shohim edhe në vitet e ardhshme. Qëllimi i Qeverisë është që kjo rritje të jetë e qëndrueshme e të vijojë të shfrytëzohet potenciali ekonomik", shkroi Bislimi.

BERZh-i: Kosova me rritjen ekonomike më të lartë në rajon

Sipas të dhënave të fundit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), të publikuara më 16 maj, rritja ekonomike mesatare e vendeve të Ballkanit Perëndimor në vitin 2023 pritet të jetë 2.2 për qind, ndërsa në vitin 2024 parashihet të rritet në 3.4 për qind. Kosova pritet ta ketë rritjen ekonomike më të lartën në rajon në vitin

2023 dhe 2024.

Kosova edhe në qeverisjet e mëhershme, sipas të dhënave të mekanizmave financiarë ndërkombëtarë, ka pasur rritjen ekonomike më të lartën në rajon. Por, edhe përkundër kësaj rritjeje, sipas njohësve të kësaj fushe, Kosova ka pasur probleme të mëdha ekonomike siç janë papunësia dhe varfëria. Me këto dy probleme Kosova është përballur ndër vite. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkalla e papunësisë në Kosovë në tremujorin e parë të vitit 2022 ishte 16.6 për qind.

Papunësia, afër 17 për qind

Kosova ndër vite ka pasur shkallë të lartë të papunësisë. Në të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të cilat mbulojnë tremujorin e parë të vitit 2022, papunësia llogaritet të jetë 16.6 për qind. Më e larta është shifra e qytetarëve ekonomikisht joaktivë. Sipas ASK-së, këta persona nuk janë të punësuar, as të regjistruar si të papunë, as nuk kërkojnë punë. Ndërkaq, të dhënat për gjithë vitin 2021 tregojnë se shkalla e papunësisë ka qenë mbi 20 për qind.

Me mbi 1.7 milion banorë Kosova konsiderohet të jetë një nga vendet më të varfra në Evropë. Të dhënat e fundit të Bankës Botërore për varfërinë në Kosovë janë të vitit 2017 dhe, sipas tyre, mbi 23 për qind e qytetarëve të Kosovës jetojnë në varfëri.

Skenderi: Kosova nuk mund të lavdërohet me rritjen ekonomike

Profesori i lëndës së Makroekonomisë dhe Mjedisit në Biznes në Universitetin e Prishtinës, Nagip Skenderi, thotë se derisa janë këto shifra të papunësisë dhe varfërisë, Kosova nuk mund të mburret me rritjen ekonomike. "Edhe pse e kemi një rritje ekonomike simbolike, nuk është ajo që adreson problemet ekonomike dhe sociale në Kosovë dhe që do ta përmirësonte gjendjen ekonomike të qytetarëve të cilët janë goditur edhe nga inflacioni i lartë", thotë Skenderi për "Radion Evropa e Lirë".

Për t'i zbutur këto probleme ekonomike dhe sociale që ka Kosova, vlerësohet se rritja ekonomike duhet të jetë dyshifrore dhe të mbajë atë trend për shumë vjet.

Profesor Skenderi thotë se në një shtet ku inflacioni është dyshifror, krijohen probleme të mëdha në ekonomi. "Shporta mujore e konsumatorit po përkeqësohet çdo ditë. Këtu është problemi më i madh", thekson ai.

Nga fundi i vitit 2021 inflacioni në Kosovë ka qenë në rritje. Norma mesatare e inflacionit në vitin 2022 ka qenë gati 12 për qind.

Rritjes së inflacionit gjetkë në botë i kanë kontribuar në masë të madhe pandemia e koronavirusit dhe lufta e Rusisë në Ukrainë.

Për ta kontrolluar inflacionin,

Banka Qendrore Evropiane ka rritur në mënyrë agresive normat e interesit, duke i çuar ato nga zero sa kanë qenë në mesin e vitit 2022, në 3.5 për qind në mars të këtij viti.

Pse ka Kosova rritje ekonomike më të lartë se vendet e rajonit?

Profesori i ekonomisë, Nagip Skenderi, thotë se arsyeja se pse Kosova ka rritjen ekonomike më të lartën në rajon është "për shkak të parave të dërguara nga diaspora dhe shpenzimet që ata bëjnë gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë". Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, vetëm vitin e kaluar remitencat kanë kapur vlerën e mbi 1.2 miliard eurove. "Përveç remitencave, një ndikim të madh, krahasuar me vendet e rajonit, ka pasur edhe rritja e sektorit të ndërtimit. Edhe ky sektor ka pasur rritje si rezultat i diasporës të cilët blejnë e ndërtojnë shtëpi në Kosovë", thotë Skenderi.

Po ashtu, një indikator tjetër që ka ndikuar në rritjen ekonomike, sipas profesor Skenderit, janë edhe investimet direkte, të cilat, gjithashtu, i atribuohen diasporës.

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, investimet e huaja në Kosovë në vitin 2022 kanë kapur vlerën e mbi 750 milionë eurove - nga mbi 420 milionë euro sa kanë qenë në vitin 2021. Sipas BQK-së, investimet më të mëdha bëhen në sektorin e patundshmërisë dhe ato vijjnë

kryesisht nga diaspora e Kosovës.

Sa është e qëndrueshme rritja ekonomike?

Për një rritje ekonomike më të qëndrueshme, profesor Skenderi thotë se duhet të dizajnohet një model tjetër i ekonomisë. "Për të pasur një rritje ekonomike të qëndrueshme, Qeveria e Kosovës duhet të përqendrohet në ndryshimin e strukturës ekonomike. Duhet t'i orientojë masat stimuluese në drejtim të sektorit prodhues". "Të gjitha paratë neve na shkojnë në importe, për gjërat që ne mund vetë t'i prodhojmë. Stimujt ekonomikë duhet të përqendrohen në sektorin e prodhimit, bujqësisë", thotë Skenderi.

Me deficitin e lartë tregtar që ka Kosova, shton Skenderi, vështirë se mund të zhvillohet ekonomia. Ish-gubernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, në një intervistë dhënë për REL-in në janar, ka paralajmëruar se deficitin tregtar është duke ndikuar negativisht në aktivitetin ekonomik të Kosovës.

Kosova importon shumicën e produkteve nga shtetet fqinje dhe ato të Bashkimit Evropian. Sipas të dhënave të ASK-së, në vitin 2022 Kosova ka eksportuar produkte në vlerë mbi 900 milionë euro, ndërsa ka importuar produkte në vlerë mbi 5 miliardë euro. Rrjedhimisht, deficitin tregtar i Kosovës në vitin 2022 ka arritur në mbi 4 miliardë euro.

A mund të krijojmë një sistem që do të parashikojë luftërat e ardhshme?



Studiuesit nga e gjithë bota po përpunojnë të ndërtojnë një sistem, i cili do t'i japë mundësi njerëzimit të parashikojë konfliktet e dhunshme përpara se ato të shpërthejnë, dhe në këtë mënyrë t'i parandalojë ato. Ata do të shqyrtojnë përparimet dramatike në Inteligjencën Artificiale vitet e fundit, dhe se si mund të ndikohen vendimet e marra nga udhëheqësit e botës, në një kohë kur lufta në Ukrainë e ka ndryshuar situatën për dhjetëra miliona njerëz.

“Ne jemi duke jetuar në një shoqëri në krizë... Dhe ekzistojnë lloje të ndryshme të ardhme jo të dëshirueshme” - tha për AFP Sirka Hainonen, profesore e studimeve të së ardhmes në Universitetin Turku në Finlandë. Heinonen ishte në mesin e rreth 30 studiuesve nga e

gjithë bota që u mbledhën në Gjenevë në fillim të këtij muaji për një raund të parë diskutimesh të fokusuar tek “Parashikimi i së ardhmes së Paqes dhe Luftës”.

“Kur i shqyrtojmë krizat e mundshme të së ardhshmes, duhet të gjejmë zgjidhje për t'i parandaluar ato që të ndodhin. Dhe për të ardhmen e preferuar, ne duhet të vendosim se cilat janë hapat dhe masat për t'i bërë ato të ndodhin” - thekson ajo. Projekti mbështetet nga Fondacioni Parashikues i Shkencës dhe Diplomacisë me seli në Gjenevë (GESDA), Qendra e Gjenevës për Politikën e Sigurisë (GCSP) dhe Shkolla e Çështjeve Ndërkombëtare dhe Publike të Universitetit të Kolumbias (SIPA). Seminari i parë i mbajtur me detyrë të mbyllura, u përqendrua në

thelb në identifikimin e mënyrave se si mund të ndodhte ky lloj parashikimi. Takimet e tjera që do të mbahen në Nju Jork dhe Gjenevë gjatë këtij viti, mund të shpjegojnë më shumë zhvillime specifike me potencialin për të ndryshuar në mënyrë dramatike rrjedhën e historisë njerëzore. Ndërsa tema mund të duket se po trajtohet në kohën e duhur, teksa po zhvillohet lufta më e madhe në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore, pjesëmarrësit në seminar theksuan se pushtimi i Ukrainës nga presidenti rus Vladimir Putin nuk ishte domosdoshmërisht fokusi i tyre kryesor.

Në vend të kësaj është ambicia për të ndërtuar një sistem për parashikimin e ngjarjeve vite dhe madje dekada përpara, dhe më pas të këshillohen

vendimmarrësit se si të lëviznin drejt rezultateve më të mira afatgjata. Në një kohë ndryshimesh të shpejta dhe rrënjësore, të cilat janë shpesh komplekse dhe të ndërlikura, parashikimi i zhvillimeve me muaj e lëre më pastaj me vite përpara është një sfidë shumë e madhe.

Ekspertët e vënë theksin edhe tek përqendrimi i pushtetit tek kompanitë që menaxhojnë të dhënat tona, dhe vendimet që mund të merren për t'i rregulluar ato. Nga ana tjetër përmendin një mori mundësish por edhe rreziqesh të lidhura me zhvillimin e shpejtë të Inteligjencës Artificiale, duke përfshirë shfaqjen e robotëve vrasës. Aleksandër Fasel, ambasadori i Zvicrës për diplomacinë shkencore, e vuri

theksin mbi shpejtësinë me të cilën ka evoluar AI në vetëm pak muaj që nga dalja në skenë e ChatGPT, duke nxitur apele për një moratorium derisa të analizohen mirë pasojat e tij.

“Thirrje të tilla janë një provë e gjallë se ne kemi nevojë për një instrument të parashikimit të ngjarjeve. ChatGPT është një çikërrimë në krahasim me atë që po vjen” - thekson ai. Për të kuptuar vështirësinë e parashikimit të zhvillimeve pas 25 viteve, Fasel na fton të kthehemi 25 vite më parë. “Në prillin e 1998-ës Putini nuk ishte ende në pushtet. Ne nuk ia dinim as emrin. Nuk kishte asnjë smartfon. Dhe kjo na jep një shembull të vogël të sfidës së madhe që kemi përpara” - thekson ai. / Science Alert - Bota.al



Vdekja e çuditshme e individit liberal



Nga Yanis VAROUFAKIS

Athinë – Im atë ishte mishërimi i individit liberal, një ironi e shkëlqyer për një marksist të përjetshëm. Për të siguruar jetesën, atij iu desh t'ia jepte me qira krahun e tij të punës drejtuesit të një fabrike çeliku në Eleusis. Por gjatë pushimit të drekës ai shëtiste i lumtur në oborrin e hapur të Muzeut Arkeologjik të Eleusis, ku kundronte pavionin plot me të dhëna që tregonin se teknologët e antikitetit ishin më të avancuar nga sa mendohej më parë.

Pas kthimit në shtëpi, çdo ditë pak pas orës 17:00, dhe pas një pushimit të shkurtër, ai do të ishte gati të merrte pjesë në jetën tonë familjare dhe më pas do të gjente hapësirë për të shkruar gjetjet e tij në artikuj dhe libra akademikë. Me pak fjalë, jeta e tij në fabrikë ishte e ndarë mjeshhtërisht nga jeta e tij personale. Ajo ishte një kohë kur edhe të majtët si ne mendonin se minimumi kapitalizmi na kishte dhënë sovranitet mbi veten tonë, ndonëse brenda disa kufijve. Sado që dikush punon fort për shefin e tij në punë, mund ta "treshojë" të paktën një pjesë të jetës së tij dhe brenda këtij "gardhi", të mbetet autonom, i vetëvendosur, i lirë.

Ne e dinim se vetëm të pasurit ishin vërtet të lirë të zgjidhnin, se të varfërit ishin kryesisht të lirë për të humbur, dhe se sklavëria më e keqe ishte ajo e kujtdo që kishte

mësuar të donte zinxhirët e tij. E megjithatë e vlerësuam vetë-pronësinë e kufizuar që kishim. Sot të rinjve i është mohuar edhe kjo.

Që nga momenti kur hedhin hapat e tyre të parë, ata mësohen haptazi ta shohin veten si një markë, por që do të gjykohej sipas origjinalitetit të perceptuar. (Dhe kjo përfshin punëdhënësit e mundshëm: "Askush nuk do të më ofrojë punë, derisa të zbuloj veten time të vërtetë"- më tha një herë një i diplomuar).

Marketingu i një identiteti në shoqërinë e sotme online nuk është fakultativ. Kurimi i jetës së tyre personale, është bërë një nga punët më të rëndësishme që bëjnë sot të rinjtë. Përpara se të postojnë ndonjë imazh, të ngarkojnë ndonjë video, të rishikojnë ndonjë film, të ndajnë ndonjë fotografi apo një postim në Twitter, ata duhet të kenë parasysh se kë do të kënaqë ose do të distancojë zgjedhja e tyre. Ata duhet të kuptojnë se cila pjesë e "vetes së tyre të vërtetë" do të duket më tërheqëse, duke testuar vazhdimisht opinionet e tyre kundër konceptit të tyre se cili mund të jetë opinioni i zakonshëm midis opinion-bërësve në internet. Për shkak se çdo përvojë mund të kapet dhe të ndahet, ato i mundon vazhdimisht pyetja nëse duhet bërë një gjë e tillë.

Edhe nëse nuk ekziston vërtet asnjë mundësi për të ndarë përvojën, ajo mundësi mund të imagjinohet lehtësisht. Çdo

zgjedhje shndërrohet në një akt për ndërtimin e kujdesshëm të një identiteti. Nuk ka nevojë të jesh i majtë për të parë se e drejta edhe kur nuk është në shitje, është e zhdukur.

Ironia është se individit liberal nuk vdiq as nga këmisha e kadifenjtë fashiste dhe as nga komisarët stalinistë. Ai u vra kur një formë e re e kapitalit, nisi t'i udhëzonte të rinjtë t'i bënin gjërat edhe më liberale: të ishin vetvetja. Nga të gjitha modifikimet e sjelljes, ajo që unë e quaj kapitali dixhital që ka gjeneruar para, është padyshim arritja e tij kryesore dhe kurorëzuese.

Individualizmi posedues ishte gjithnjë i dëmshëm për shëndetin mendor. Shoqëria tekno-feudale që po krijon kapitalin dixhital i bëri gjërat shumë më keq kur e shkatërroi gardhin ndarës që i siguronte individit liberal një strehë nga tregu i punës. Kapitali dixhital e ka copëtuar individin në fragmente të dhënash, një identitet i cili përfshin zgjedhje të shprehura me klikime, në të cilat algoritmet e tij janë në gjendje t'i manipulojnë në mënyra që asnjë mendje njerëzore nuk mund t'i kuptojë. Ai ka prodhuar individë që nuk janë edhe aq posesivë sesa të poseduar, ose më saktë persona të paafte për vetë-posedim.

Ai e ka pakësuar kapacitetin tonë për t'u fokusuar duke zgjedhur vëmendjen tonë.

Ne nuk jemi bërë vullnet-dobët. Jo, fokusi ynë është i rrëmbyer nga një

klasë e re sunduese. Dhe për shkak se algoritmet në rrjet dihet se përforcojnë patriarkalizmin, stereotipet djallëzore dhe shtypjen para-ekzistuese, më të rrezikuarit – vajzat, të sëmurët mendorë, të marginalizuarit dhe të varfërit – janë ata që vuajnë më shumë. Nëse fashizmi na mësoi diçka dikur, kjo është ndjeshmëria jonë ndaj stereotipeve demonizuese dhe tërheqjes (dhe fuqisë) së shëmtuar të emocioneve si drejtësia, frika, zilia dhe urrejtja që ato ngjallin tek ne. Në realitetin tonë bashkëkohor shoqëror, bota dixhitale na vendos ballë për ballë me "tjetrin" të frikësuar dhe të urreyer.

Dhe për shkak se dhuna në internet na duket pa gjak, ne kemi më shumë gjasa t'i përgjigemi këtij "tjetrit" me gjuhë tallëse dhe madje nënçmuese. Fanatizmi është kompensimi emocional i tekno-feudalizmit për frustrimet dhe ankthet që përjetojmë në lidhje me identitetin dhe fokusin.

Moderatorët e komenteve dhe rregullimi i gjuhës së urrejtjes nuk mund ta ndalojnë këtë brutalizim, sepse është thelbësor për kapitalin iCloud, algoritmet e të cilit optimizohen për fitimet e bollshme që shkojnë për pronarëve e Big Tech. Rregullatorët nuk mund të rregullojnë algoritmet e drejtura nga Inteligjenca Artificiale që nuk mund t'i kuptojnë as autorët e tyre. Që liria të ketë një shans, duhet të socializohet kapitali dixhital. Babai im besonte se gjetja e diçkaje që ishte përjetësisht të bukur për t'u


fokusuar, siç bëri duke u çuditur tek reliktet e lashtësisë greke, është mbrojtja jonë e vetme nga demonët që rrethojnë shpirtin tonë. Unë jam përpjekur ta praktikoj këtë gjatë viteve dhe në mënyrën time.

Por përballë tekno-feudalizmit, të vepruarit vetëm, të izoluar, dhe si individë liberalë, nuk do të na çojnë shumë larg. Shkëputja nga interneti, filja e telefonave celularë dhe përdorimi i parave fizike në vend të kartave bankare nuk është zgjidhje. Nëse nuk bëhemi bashkë, nuk


do të arrijmë asnjëherë të civilizojmë apo shoqërizojmë kapitalin dixhital, dhe nuk do ta rifitojmë dot pavarësinë tonë mendore nga kontrolli i tij.

Dhe këtu qëndron kontradikta më e madhe: vetëm një ri-konfigurim gjithëpërfshirës i të drejtave të pronësisë mbi instrumentet gjithnjë e më të bazuara tek kapitali dixhital, të shpërndarjes, bashkëpunimit dhe komunikimit mund të shpëtojë idenë themelore liberale të lirisë siç do të kërkojë vetë-pronësia. Prandaj, ringjallja e individit liberal kërkon pikërisht atë që liberalët e urrejnë: një revolucion të ri.

Shënim: Yanis Varoufakis, ish-Ministër i Financave i Greqisë. Aktualisht është udhëheqës i partisë MeRA25 dhe profesor i ekonomisë në Universitetin e Athinës. / "Project Syndicate" – Bota.al



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Besa Famgas fiton finalen e parë

PEJË, 21 MAJ - Besa Famgas ka fituar ndeshjen e parë finale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll. Në atmosferë të bukur sportive, para një numri të madh shikuesish në palestrën

“Karagaçi”, Besa mposhti Trepçën me rezultat 30:27. Ndeshja e së shtunës ishte e fortë dhe e hapur deri në aksionet e fundit. Më shumë shfaqti skuadra vendase që festoi në fund. Ndeshja e dytë e

serisë finale luhet të enjten në Mitrovicë. Në minutat e para në avantazh ishte skuadra mysafire. Pas minutës së 15-të Besa doli para dhe ka mbajtur epërsinë deri në fund. Trepça u afrua në një gol, por pa

mundur të barazojë, ndonëse ka bërë përpjekje deri në fund. Nikola Prce i realizoi 8 gola për Besën, ndërsa 6 i kishte Arbios Mushkolaj. Te Trepça nga 6 gola i shënuan Deniz Terziqi, Sali Maxhera e Lulzim Shabani.



Rama dhe Krasniqi paralajmërojnë spektakël më 5 gusht

Më 5 gusht në Prishtinë adhuruesit e sportit do të kenë mundësinë që të arkëtohen, pasi boksieri i madh shqiptar nga Juniku, Haxhi Krasniqi do të garon në kategorinë gjysmë të rënd. Boksieri Krasniqi dhe kryetari i Prishtinës, Përparim Rama kanë paralajmëruar një natë të paharrueshme të boksit

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 MAJ - Boksieri shqiptar Robin (Haxhi) Krasniqi ditë më parë nëpërmjet një video në “Facebook” ka bërë të ditur se më 5 gusht në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë do të boksojë. Boksieri me prejardhje nga Juniku do të garon në kategorinë gjysmë të rënd, derisa emri i kundërshtarit do të bëhet i

ditur në ditët në vijim. Të dielën kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama e ka pritur boksierin Krasniqi, i cili më 5 gusht do t’ua plotësojë dëshirat dhe ëndrrat krejt tifozëve për të boksuar në Prishtinë. I pari i kryeqytetit së bashku me Krasniqin kanë pozuar në stadiumin “Fadil Vokrri”, derisa është shprehur optimist se nata e 5 gushtit do të jetë një spektakël të jashtëzakonshëm.

“Robin Krasniqi vjen për herë të parë në stadiumin e kryeqytetit! Mbrëmje historike boks: Më datë 5 gusht, stadiumi ‘Fadil Vokrri’ do të mbushet me adrenalinën e një eventit historik të një nate të paharrueshme boksit profesional ndërkombëtar. Përgatituni për një spektakël të jashtëzakonshëm”, ka shkruar Rama në “Facebook”. “Së bashku të pamundurën e bëjmë



të mundur. Ashtu siç e tha edhe kryetari na pret një natë historike, më 5 gusht në

stadiumi ‘Fadil Vokrri’ Prishtinë. Faleminderit Përparim Rama”, ka thënë Krasniqi.

Ballkani kampion i Kosovës, Gjilani siguron pozitën e tretë



PRISHTINË, 21 - FC Ballkani është kampion i Kosovës në futboll për të dytin vit radhazi. Skuadra portokallezi deri te ky sukses arriti pas fitores 2:0 kundër Ferizajt, në shtëpi, të shtunën, në kuadër të javës së 35-të në Albi Mall Superligë, por edhe falë humbjes së Dritës para tifozëve të vet ndaj Malishevës. Kësisoj, një javë para përfundimit të edicionit, skuadra e drejtuar nga Ilir Daja, e ka siguruar pozitën e parë në tabelë. Golat e fitores për Ballkanin i shënuan Edvin Kuq në minutën e 65-të dhe Meriton Korenica në minutën e 76-të.

Ceremonia e ndarjes së titullit të kampionit për Ballkanin do të organizohet në xhiron e fundit në ndeshjen Gjilani-Ballkani. Malisheva ka arkëtuar tri pikë të mëdha si mysafire, duke e mposhtur Dritën, me rezultat 1:0, duke e siguruar në këtë mënyrë mbetjen në elitë. Golin e fitores për Malishevën e shënoi Sobowale (56’). Gjilani e ka siguruar pozitën e tretë në renditje, e cila siguron pjesëmarrjen në garat evropiane, pas barazimit të sotëm në “Zahir Pajaziti” kundër Llapit (2:2), derisa Prishtina

shënoi fitore të lehtë ndaj Drenicës, 4:1 në stadiumin “Fadil Vokrri”. Fitore para tifozëve të vet realizoi edhe Dukagjini, që e mposhti Trepçën’89, me rezultat 3:1. Kësisoj, gjithçka sa i përket skuadrës që do t’i bashkohet Drenicës në një rang më të ulët të garave dhe skuadrës që do të luajë në barazh do të vendoset në javën e fundit, në ndeshjet Trepça’89-Prishtina dhe Ferizaj-Dukagjini. Aktualisht Ferizaj ndodhet në pozitën e 8-të, me 38 pikë, kurse Trepça’89 ka një pikë më pak.

FBK-ja: Faleminderit për një super edicion në Prince Caffè Superligë

Prishtinë, 21 maj - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) falënderon të gjithë pjesëmarrësit për një edicion fantastik dhe të jashtëzakonshëm në Prince Caffè Superligë. “Interesimi ishte i jashtëzakonshëm në këtë edicion nga java e parë deri në fund, ku u përmbyll me finalen e pestë mes Trepçës dhe Pejës, që u vendos në vazhdime, duke dëshmuar për super kampionatin që kemi pasur.

Numrin e madh të shikuesve e kanë lakmi edhe shumë shtete tjera dhe shpresojmë që do të vazhdojmë furishëm e me suksese në edicionin e ri. Rivaliteti dhe sfidat interesante na kanë përcjell gjatë gjithë kampionatit, që është vlerësuar si ndër më interesantit pasluftës në basketbollin e Kosovës”, thuhet në letrën falënderuese të FBK-së. “FBK-ja falënderon nga

zemra klubet, trajnerët, lojtarët, punëtorët sportivë, tifozët, mediat, si dhe të gjitha Grupet e Interesit në Basketboll, që na kanë dhuruar emocione pafund. Falënderim i madh është për sponsorët dhe kontribuuesit në basketboll, që edhe kësaj radhe ishin pranë nesh. Ndiham e tyre është jetike për ne dhe zhvillimin e sportit tonë të dashur. Falënderojmë nga zemra: Ministrinë e



Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Bankën TEB, Prince Caffè, Art Motion, Kujtesën, Kompaninë IP, Automita-n,

Tre Pharm dhe Stobi Flips Kosova”, thuhet ndër të tjera në letrën e Federatës së Basketbollit.


24 vjet pa ty

BAKI B.BELA

(1927-1999)

Sot më 21 maj u bën 24 vjet, kur barbarët serbë na e vranë, babain, vjerrin dhe gjyshin tonë të dashur.

E përkujton me mall: djali Xhemali me bashkëshorten Mevliden; vajza Nadirja, nipat Afeti dhe Muhameti, mbesat Selvetja, Adifetja dhe Albana nga Beljanët (Koshorishtë), e Dushkajës së Kaçanikut.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valton Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Mentori B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 601640726.

Negmije Bungu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.

- Afrim Smjali shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani".

Emrije Vilaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Naim Frasheri " Vlashnje.

- Autoservis Beni-VW AUDI-VAG shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 80273029.

Xhelal Ninaj shpall te pavlefshme dëftesat e lp I - VIII shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

Erna Jamini shpall te pavlefshme dëftesat shfmu " Fetah Sylejmani " Dragash.

Enes Konjuhi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. I-V të shkollës " Nexhmi Mustafa" Besi Prishtinë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Bleona Konjuhi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I-V të shkollës "Nexhmi Mustafa" Besi Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

Amanta Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues